

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKTA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Mejreme Memaj kryetare e kolegjit, Have Haliti dhe Driton Muharremi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve R.V. dhe A.V. nga Prishtina, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit R.V., av. Z.K. dhe ankesës së të akuzuarit A.V., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DRK në Prishtinë PKR.nr.386/2017 të datës 29.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 par.1 të KPPK- së, me datë 22.02.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit R.V. dhe ankesës së të akuzuarit A.V., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore DRK në Prishtinë PKR.nr.386/2017 i datës 29.12.2017, vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin me burgim dhe me gjobë, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit R.V. dhe A.V., për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykon të akuzuarit R.V. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet e 2 (dy) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetë qind) €, ndërsa të akuzuarin A.V., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetë qind) €, në të cilin dënim iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.10.2017 deri më dt. 28.12.2017, e në rast se të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë, gjykata do të ju zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, në atë mënyrë, që për çdo 20 € të gjobës së shqiptuar, do t'iu llogaritet nga një ditë burgim.

II. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DRK në Prishtinë PKR.nr.386/2017 të datës 29.12.2017, të akuzuarit Rinor dhe A.V., janë shpallur fajtorë për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe janë gjykuar: i akuzuari R.V., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.10.2017 deri më dt. 28.12.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) €, kurse i akuzuari A.V., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.10.2017 deri më dt. 28.12.2017, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (një mijë) €, të cilën gjobë janë obliguar ta paguajnë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, e nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë, gjykata do të ju zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, në atë mënyrë, që për çdo 20 € të gjobës së shqiptuar, do t'iu llogaritet nga një ditë burgim.

Të akuzuarve iu është shqiptuar dënim plotësues: të akuzuarit R.V., i është konfiskuar një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1.3 gr. dhe telefoni IPHONE 6 me nr.045630635, të akuzuarit A.V., i është konfiskuar një qese me substancë narkotike në peshë prej 8.7 gr. një telefon IPHON 5 me nr. tel. 044-424-397, një telefon Samsung me nr.044-729-819, si dhe para në shumë prej 118,90 €, të cilat janë përfituar nga kryerja e veprës penale, kurse në shtëpinë e të dy të akuzuarve është konfiskuar edhe substanca narkotike në peshë prej 989,7 gr. si mjete që janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

Të akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor janë të obliguar që të paguajnë shumën prej nga 50 €, secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit R.V., av. Z.K., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ulët apo dënim i kushtëzuar.

I akuzuari A.V., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, ashtu që të i shqiptojë dënim të kushtëzuar dhe dënim më të ulët me gjobë.

Prokuroria e Apelit me shkresën PPA/I.nr.51/18 të datës 02.02.2018, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit R.V. dhe e të akuzuarit A.V., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, në të cilën prezantuan, i akuzuari Rinor Vija dhe mbrojtësi i tij av. Z.K., i akuzuari A.V., ndërsa në seancë nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse ishte njoftuar me rregull për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit dhe ankesën e të akuzuarit dhe gjeti se:

Ankesat e të akuzuarve, janë të bazuara.

Gjykata e Apelit, duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Por ashtu, as gjendja fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi nga kjo gjykatë, me ankesë nuk mund të kontestohet aktgjykimi konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, sepse të akuzuarit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprën e cila iu vihet në barrë, pas konsultimit me mbrojtësit e tyre, kryetari i trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësojë vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore, përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.V., në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i ashpër, i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, të cilin pranim e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, kurse gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit nuk i ka vlerësuar sa duhet rrethanat lehtësuese sipas të cilave ka vend për një dënim më të butë apo dënim të kushtëzuar në mungesë të rrethanave rënduese.

Ndërsa i akuzuari A.V., në ankesë pretendon, se e ka pranuar fajësinë, është penduar për kryerjen e veprës penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, se është i ri në moshë dhe gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur rrethana rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit, se dënimi i shqiptuar është i ashpër, bazuar në rrethanat lehtësuese ka bazë që t'i shqiptohet një dënim i kushtëzuar, si dhe dënimi me gjobë të jetë më i ulët, sepse e ka gjendjen e varfër ekonomike, se e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën e kryer penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra tjetër penale dhe në mungesë të rrethanave rënduese ka aplikuar dispozitat nga neni 75, 76 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe iu ka shqiptuar dënim me burgim nën minimumin e paraparë me dispozitat ligjore me bindje se me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të akuzuarve.

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, konsideron se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat relevante për matjen e dënimit, e që i pranon edhe kjo gjykatë dhe gjenë se në pranimin e rrethanave lehtësuese ka vend për shqiptimin e dënimit më të butë duke marrë parasysh, si sjelljen e të akuzuarve dhe sinqeritetin e tyre rreth asaj se çka i ka shtyer të kryejnë këtë veprë penale (gjendja e vështirë ekonomike) se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe pendimin e tyre për veprën e kryer penale, e që në veti përfshinë vetëdijësimin e të akuzuarve për veprën e kryer penale, atëherë konsideron se në mungesë të rrethanave rënduese ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë, prandaj edhe e ndryshoj vendimin mbi dënim dhe të njëjtit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të

akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Prandaj, nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 403 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.47/2018 me 22.02.2018

Procesmbajtësja,

Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

Have Haliti\_\_\_\_\_

Driton Muharremi\_\_\_\_\_

Kryetare e kolegjit,

Mejreme Memaj